



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 13 (827817)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 mars 2023

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Të jesh pjesë e FA dhe t'i shërbesh vendit tënd është nder dhe privilegj!

Në Bazën Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë, zhvillohet 'Ditë e hapur'. Pjesëmarrës në këtë aktivitet, ishin gjimnazistët dhe stafi pedagogjik i shkollave të mesme të përgjithshme dhe ato profesionale mekanike "Stiliano Bandili" Berat, "Kristo Isak" Berat, "Riza Mulita", Starovë, gjimnazi "5 - Tetori" Kuçovë dhe ai "Shefqet Shuaipi", Lumas, të cilët u pritën nga komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë kolonel Adrian Kuli. Në këtë ditë të hapur, gjimnazistët patën

mundësinë të shikonin dhe të informoheshin mbi veprimtarinë e Bazës Ajrore Kuçovë, të preknin nga afër mjetet ajrore, teknikën, modelet dhe funksionimin e tyre. Në vijim, të pranishmit u njohën, nëpërmjet stendave të ngritura për këtë qëllim, me teknikën dhe pajisjet që përdoren nga pilotët dhe teknikët e Bazës Ajrore Kuçovë, duke marrë njëkohësisht edhe informacionin e nevojshëm nga personeli i Qendrës së Rekrutim Personelit (QPR), mbi mundësitë e punësimit që ofron

kjo bazë në disa specialitete teknike, inxhinier elektronik/mekanik për sistemet e komunikimit ajror. I pranishëm në këtë aktivitet, ishte edhe komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili pasi përshëndeti gjimnazistët dhe stafin pedagogjik, shprehu se: "Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura dhe t'i shërbesh vendit tënd është nder dhe privilegj! Ju sugjeroj ta shikoni me prioritet që të bëheni anëtarë të familjes së..."



»» faqe 2

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Konferencën e Komandantëve Detarë të NATO-s



Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes viziton Forcën Tokësore

Forca Tokësore (FT), u vizitua nga kursantët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM). Zëvendëskomandanti i FT-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, duke iu uruar mirëseardhjen në Forcën Tokësore, kursantëve të KLSM-së, iu shprehu përgëzimet e tij për ndjekjen e këtij kursi, i cili renditet në majën e piramidës së kurseve institucionale për Forcat e Armatosura. Më tej, takimi vijoi me mbajtjen e një prezantimi informues nga shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili dhe nga shefi...



»» Faqe 3

BALONAT, rikthim në betejën e luftës për informacionin

Fillimi i vitit 2023 risolli në vëmendje balonat, këto instrumente të vjetra të luftës në përgjithësi dhe spiunazhit në veçanti. Balonat rezultojnë të jenë efikase në luftën aktuale të grumbullimit të informacionit, megjithëse shekulli XXI, i përket epokës digjitale me satelitët dhe inteligjencën artificiale. Balonat në këtë rast kanë bërë "maskimin" e teknologjisë shumë të avancuar kineze me një veshje të vjetër, siç janë balonat. Balonat nuk i zëvendësojnë satelitët dhe as disiplinat...



»» Faqe 5

Bajram Curri, historia e vlerë e kombit shqiptar

Me origjinë nga fisi i njohur i Krasniqes (Malësia e Gjakovës), i lindur në Gjakovë, Bajram Curri u shqua si veprimtar i lëvizjes kombëtare të periudhës së Rilindjes, duke qenë një ndër udhëheqësit politikë e ushtarakë të kryengritjeve popullore kundër-osmane dhe të luftës për çlirim dhe bashkimin kombëtar të vendit. Ishte një ndër organizatorët e Lidhjes Shqiptare të Pejës (1899-1900) dhe veprimtar i saj për autonominë e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit, drejtues kryesorë në kryengritjet kundër-osmane...



»» Faqe 7

Gjeneral brigade Ylli Pulaj: Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura dhe t'i shërbesh vendit tënd është nder dhe privilegj! Bëhuni anëtarë të familjes së madhe të Forcave të Armatosura, veçanërisht në radhët e Forcës Ajrore!

Në Bazën Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë, zhvillohet 'Ditë e hapur'. Pjesëmarrës në këtë aktivitet, ishin gjimnazistët dhe stafi pedagogjik i shkollave të mesme të përgjithshme dhe ato profesionale mekanike "Stiliano Bandili" Berat, "Kristo Isak" Berat, "Riza Mulita", Starovë, gjimnazi "5 - Tetori" Kuçovë dhe ai "Shefqet Shuapi", Lumas, të cilët u pritën nga komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë kolonel Adrian Kuli.

Në këtë ditë të hapur, gjimnazistët patën mundësinë të shikonin dhe të informoheshin mbi veprimtarinë e Bazës Ajrore Kuçovë, të preknin nga afër mjetet ajrore, teknikën, modelet dhe funksionimin e tyre.

Në vijim, të pranishmit u njohën, nëpërmjet standave të ngritura për këtë qëllim, me teknikën dhe pajisjet që përdoren nga pilotët dhe teknikët e Bazës Ajrore Kuçovë, duke marrë njëkohësisht edhe informacionin e nevojshëm nga personeli i Qendrës së Rekrutim Personelit (QPR), mbi mundësitë e punësimit që ofron kjo bazë në disa specialitete teknike, inxhinier elektronik/mekanik për sistemet e komunikimit ajror.

I pranishëm në këtë aktivitet, ishte edhe komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili pasi përshëndeti gjimnazistët dhe stafin pedagogjik, shprehu se: "Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura dhe t'i shërbesh vendit tënd



është nder dhe privilegj! Ju sugjeroj ta shikoni me prioritet që të bëheni anëtarë të familjes së madhe të Forcave të Armatosura, veçanërisht në radhët e Forcës

Ajrore, pasi kemi të bëjmë me një forcë në zhvillim të vazhdueshëm, elitare në kualifikime/trajnime brenda dhe jashtë vendit, e cila ka në përdorim teknikë dhe

pajisje të reja e moderne, siç janë dronët, të cilat kërkojnë përkushtim dhe të japin kënaqësi në përdorimin e tyre".

Aktiviteti, vijoi më tej me ndjekjen

e fluturimeve demonstruese të helikopterëve, të cilët krijuan një atmosferë të këndshme që la mbresa të shumë të mira tek të gjithë gjimnazistët e pranishëm.

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua 'Ditë e Hapur' me gjimnazistë të shkollave të mesme

Në kuadër të fushatës së rekrutimeve në Forcat e Armatosura, në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua 'Ditë e Hapur'. Pjesëmarrës në këtë aktivitet, ishin gjimnazistët dhe stafi pedagogjik i shkollave jo-publike "Harry T. Fultz" Tiranë, "Mihal Ekonomi", Durrës dhe shkolla e mesme e bashkuar "Mersin Duqi", Ibë, të cilët u pritën nga komandanti i Bazës Ajrore Farkë, kolonel Dritan Dyrnishaj.

Në këtë ditë të hapur, gjimnazistët patën mundësinë të shikonin dhe të informoheshin mbi veprimtarinë e Bazës Ajrore Farkë, të preknin nga afër mjetet ajrore, modelet dhe funksionimin e tyre.

Në vijim, të pranishmit u njohën nëpërmjet standave të ngritura për këtë qëllim, me teknikën dhe pajisjet që përdoren nga pilotët dhe teknikët e Bazës Ajrore Farkë, duke marrë njëkohësisht edhe informacionin e nevojshëm nga personeli i Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), mbi mundësitë e punësimit që ofron kjo bazë.



I pranishëm në këtë aktivitet, ishte edhe komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili në fjalën e tij përshëndeti gjimnazistët dhe stafin pedagogjik duke cituar: "Ju jeni sot këtu që të njiheni më nga afër me natyrën ushtarake të kryerjes së një detyrë, me uniformën që mban kjo forcë ushtarake, me avantazhet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura dhe veçanërisht të Forcës Ajrore shqiptare. Unë ju ftoj të bëheni pjesë e Forcës Ajrore, e cila do t'ju japë mundësinë e fitimit të një profesioni, do

t'ju sigurojë të ardhura mesatare më të mira të krahasuara me pozicionet e tjera të punës në fushat jashtë FA-së, do t'ju përgatisë për t'u përballuar me vështirësitë dhe do t'ju bëjë më të fortë e më të durueshëm në zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ju mund të ndesheni në jetën e përditshme."

Aktiviteti, vijoi më tej me ndjekjen e fluturimeve demonstruese të helikopterëve, të cilët krijuan një atmosferë të këndshme që la mbresa shumë të mira tek të gjithë gjimnazistët e pranishëm.

Forca Ajrore shpëton katër alpinistë në Malin e Jezercës

Efektivët e Bazës Ajrore Farkë kanë bërë të mundur shpëtimin e katër alpinistëve serbë, të cilët kishin mbetur të bllokuar në Malin e Jezercës. Mbas marrjes së njoftimit, strukturat e bazës ajrore vendosën në dispozicion helikopterë për kërkimin dhe gjetjen e vendndodhjes së turistëve, që kishin kërkuar ndihmë. Koha e reagimit të helikopterëve ka qenë tepër e shpejtë, që nga marrja e sinjalit dhe deri në lokalizimin dhe transportimin e turistëve të bllokuar në lartësitë e Jezercës.

Një prej alpinistëve ka pasur thyerje të brinjëve, e për pasojë është transportuar drejt spitalit të traumës në Tiranë. Vlen për t'u theksuar që operacioni është zhvilluar në një lartësi të madhe, mbi 2100 m mbi nivelin e detit.



Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Konferencën e Komandantëve Detarë të NATO-s

Në Komandën e Forcave Detare të NATO-s (MARCOM), Northwood, Mbretëria e Bashkuar, u zhvillua Konferenca e Komandantëve Operacionalë Detarë të Aleancës, në të cilën mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra.

MOCC është një angazhim vjetor i MARCOM me përfaqësues komandantët e flotave aleate dhe partnere, e cila ofron mundësinë për të diskutuar gjendjen e NATO-s detare në epokën e DDA (Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area).

MOCC23, ka në thelb forcimin e trajnimeve dhe ushtrimeve, në të cilën tema e MOCC e këtij viti ishte "Parandalimi dhe Mbrojtja".

Në konferencë u trajtuan jo vetëm tema nga zhvillimet e deritanishme MARCOM, por edhe koncepti se si kanë ndryshuar forcat detare në përshtatje me nevojat dhe detyrat sipas kohëve. Siguria Detare është



çelësi për paqen dhe prosperitetin tonë dhe lufta e agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës i ka shkatërruar këto ideale dhe ka ndryshuar ndjeshëm mjedisin e sigurisë.

Proceset e vendeve të Aleancës në vendimmarrje përmirësojnë planifikimin dhe efektivitetin e sistemit të reagimit ndaj krizave.

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral, Adnand Agastra gjatë kohës së qëndrimit pati takim bilateral me komandantin e MARCOM nënadmiralet Mike Utley, homologë komandantë të forcave detare respektive si dhe me oficerët e Forcës Detare, kapitenin i rangut II Blerim Hoxha, kapitenin i rangut II Edison Hoxha që përfaqësojnë Shqipërinë në MARCOM.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes viziton Forcën Tokësore

Forca Tokësore (FT), u vizitua nga kursantët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM).

Zëvendëskomandanti i FT-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, duke iu uruar mirëseardhjen në Forcën Tokësore, kursantëve të KLSM-së, iu shprehu përgëzimet e tij për ndjekjen e këtij kursi, i cili renditet në majën e piramidës së kurseve institucionale për Forcat e Armatosura.

Më tej, takimi vijoi me mbajtjen e një prezantimi informues nga shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili dhe nga shefi i G 5/8 kolonel Agim Shahu, ku të pranishmit u njohën me misionin, rolin dhe detyrat kryesore që përmbush Forca Tokësore, si struktura më e madhe e Forcave të Armatosura.

Më pas, takimi vijoi në formën e një diskutimi të lirë me pyetje-përgjigje, nga pjesëmarrësit dhe u mbyll me shkëmbimin e dhuratave simbolike si dhe me realizimin e një fotoje të përbashkët.

Vizita e KLSM-së në Forcën Tokësore, vjen në kuadër të programit akademik të këtij kursi.



Batalioni i Parë i Këmbërorisë, mikpritë kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), në një vizitë njohëse



Batalioni i Dytë i Këmbërorisë, si bërthama e Grup Batalionit të Këmbërorisë së Lehtë, stërvitet çdo ditë me intensitet, për ruajtjen dhe rritjen e aftësive profesionale.



Skënder Doçi, sfidoi moshën, detin e vështirësitë e tij, lodhjen e punës në det e në tokë, por mbi të gjitha ka sfiduar luftën dhe riskun e saj

Skënder Doçi lindi në Tropojë, më 15.04.1936, nga një familje me tradita të njohura atdhetare. Ai u rrit me jehonën e miteve e kreshnikëve, bukurinë e zanave e shtojzovalleve, me burrërinë, trimërinë e atdhedashurinë e bacës Bajram Curri... Ai është djali i Veli Niman Doçit, ish-komandantit të Brigadës 25 Sulmuese, që luftoi me pushkë në dorë për çlirimin e Atdheut, nga i cili, Skënderi trashëgoi shpirtin luftarak e patriotizmin e flakët. Pas përfundimit të shkollës tetëvjeçare në vendlindje, u ul në bankat e Shkollës Ushtarake "Skënderbej". Pas Shkollës "Skënderbej" i del bursa për të vazhduar Shkollën e Lartë të Marinës "Kirov", në Baku të Azerbajxhanit, atëherë pjesë e Bashkimit Sovjetik. Si në shkollën "Skënderbej" dhe në Shkollën e Lartë të Marinës, në Baku, ka qenë nxënës dhe student shembullor. Shkollën e Lartë të Marinës e mbaron me rezultate të shkëlqyera. Për arritje të larta në mësim, maturinë e pjekurinë e tij, Skënderi ka qenë për katër vjet të shkollës së lartë, përgjegjës i grupit të studentëve shqiptarë.

Pas përfundimit të studimeve e caktuan në Nëndetëse, që sapo kishin ardhur në Shqipëri, njësi që përmblihte në vetvete një armë të re sa të misterhme, aq dhe element krenarie për të shërbyer në të. Më vonë, bëhet komandant i saj. Që në fillim të karrierës, ai spikati në çdo drejtim. Falë përgatitjes së gjithanshme, në vitin 1961, u emërua komandant i Nëndetëses së Dytë. Këtu, ai tregoi aftësi të rralla në drejtimin e Nëndetëses nën ujë. Dijet e njohja në perfeksion të asaj anije misterioze, zhdërvjelltësia në zgjidhjen e situatave rrisuese për



jetën e efektivit e të anijes nën ujë, personaliteti i tij, bënë që shpejt efektivit ta ndjente jetën të sigurt në lundrim me komandant Skënderin, i cili u rrinte afër detarëve e kuadrove, si komandant, si shok, si prind. ...Vlen të përmendet, veç të tjerave, fakti kur Skënder Doçi tregoi vigjilencë e atdhetari, kur rusët, në pamundësi për të marrë të katër nëndetëset tona, filluan të sabotonin duke kërcënuar e kryer akte sabotazhi. Në nëndetësen e tij, kolegu rus deshi të merrte fshehtas Formularin Taktik e Teknik të përdorimit luftarak të nëndetëses, që ishte mjaft i domosdoshëm në përdorimin praktik të anijes, por Skënderi me vigjilencë dhe me forcën e tij fizike, ia rrëmbëu nga duart rusit duke e ruajtur si gjë të shtrenjtë në nëndetëse. Po ashtu, ai refuzoi të dorëzojë armatimin personal të tij, pistoletën "Makarov", të cilat rusët, nga frika që kishin nga shqiptarët, deshën t'i çarmatosin, duke kërkuar dorëzimin e armatimit personal. Skënderi, forcërisht nuk e dorëzoi pistoletën dhe nuk u çarmatos.

Gjatë gjithë jetës si kuadër i lartë i FLD-së, është karakterizuar nga pjekuria, aftësitë e larta politike e ushtarake, ku spikati në fushën politike dhe të edukimit, urtësia e matura në trajtimin e në zgjidhjen e situatave e të problemeve të shumta që kishte FLD-ja, dashuria dhe respekti për detarët e kuadrot e kësaj arme të vështirë. Në Brigadën e Nëndetëseve, ai shërbeu tre vite si zëvendëskomandant dhe 8

vite të tjera si komandant e komisar nëndetëseje.

Më pas, për shumë vite ai ka qenë komisar i Bazës Ushtarake Detare të Sazanit e Vlorës si dhe Komisar i Flotës Luftarake Detare, ku doli në pension. Pas daljes në pension, ai shkoi të banoj familjarisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por me nisjen e luftës nga UÇK për çlirimin e Kosovës, ai rikthehet tashmë si pjesëmarrës aktiv në këtë luftë, përkatësisht komandant i batalionit "Atlantik" i krijuar në SHBA e që erdhi në frontin e kësaj lufte.

Gjithashtu, Skënderi, ka luajtur shumë mirë futboll dhe volejball. Deshi që ta merrte ekipi i "Partizanit", por emërimi në nëndetëse e pengoi. Por mbi të gjitha, Skënderi ka qenë një njeri shpirtgjerë, i dashur dhe i fjalës. Ja si e kujton atë kolegu i tij Mhill Marku: "Unë kam qenë me fat që e kam njohur nga afër Skënder Doçin, kam lundruar e kam punuar në sektorin politik të FLD-së me të dhe gjithmonë kam ndjerë dorën e ngrohtë të tij, gjë për të cilën i jam mirënjohës. ...Edhe sot e kësaj dite, kur mbi supe i rëndojnë vitet e moshës së thyer, në ballë i brazdohen rrudhat si dallgë e flokët e bardhë si shkuma e detit, mbahet i fortë dhe shumë vital.

Ka sfiduar moshën, ka sfiduar detin e vështirësitë e tij, lodhjen e punës në det e në tokë, por mbi të gjitha ka sfiduar si askush nga ne luftën dhe riskun e saj"

Petrit Myftiu, komandanti i parë i nëndetëseve shqiptare

Petrit Myftiu, është një tjetër skënderbagas që pati një karrierë të suksesshme në Forcat e Armatosura, ku arriti të bëhej dhe komandant i Nëndetëseve shqiptare. Ai është njëkohësisht dhe autor i disa librave me karakter historik e kujtime që lidhen me Forcat Luftarake Detare të Shqipërisë. Petriti ka lindur më 7 prill 1937, në Elbasan në një familje me tradita arsimdashëse patriotike dhe atdhetare. Babai, Ali Myftiu, është shpallur "Mësues i Popullit", si dhe një shkollë në Elbasan mban emrin e tij. Karrierën dhe jetën ushtarake e nisi në bankat e Shkollës Ushtarake "Skënderbej", në vitet 1949-1952. Në shkollën "Skënderbej" u shfaqën cilësitë e tij më të mira, ku u dallua në mësim. Dërgohet për studime në shkollën e lartë ushtarako-detare në Baku të Azerbajxhanit. Në mësim dhe studime ishte i pari, ku i përfundon me rezultate të shkëlqyera. Këtu meritoi Medaljen e Artë, ndërsa emri i tij u gdhend me germa të arta në tabelën e mermertë të shkollës. Me mbarimin e Akademisë Ushtarake në Baku, Petrit Myftiu emërohet në bazën ushtarako detare të Pashalimanit, në repartin e nëndetëseve. Këto ende nuk ishin akomoduar në bazën e Pashalimanit. Petritin mund ta quajmë pionierin e parë të Brigadës së Nëndetëseve. Ai punoi me përkushtim dhe mori pjesë aktivisht që në fillimet e para të ndërtimit të vendbazimit të nëndetëseve, në mars të vitit 1957. Në moshën 20-vjeçare, emërohet zëvendëskomandant i Nëndetëseve. Me fillimin e vitit 1958, Petriti me ekipazhet e katër nëndetëseve dhe shtabin e brigadës shkojnë në Sevastopol. Aty filluan nga përgatitja speciale për përdorimin luftarak të nëndetëseve, këtyre anijeve tepër të misterhme të kohës. Në prill të vitit 1958, Petrit Myftiu për aftësitë e tij të dukshme dhe të zellshme në detyrë, emërohet komandant nëndetëse. Nga muaji gusht 1958, katër nëndetëset, nën drejtimin e ekipazheve të përbashkëta shqiptaro-sovjetike, mbërrin në bazën e Pashalimanit. Me fillimin e punës marinarë dhe komandantët shqiptarë u dalluan për një përgatitje të lartë e përkushtim maksimal të përvetësimit të aftësive taktiko-teknike dhe luftarake e lundruese në drejtimin e nëndetëseve. Petriti dhe pse në moshë të re, iu përkushtua detyrës, pasi përgjegjësia ishte e dukshme dhe tepër e madhe. Që në fillim shfaqti aftësi në komandimin e nëndetëses, ku në drejtimin e nëndetëses kishte një efektiv deri në 60 marinarë dhe oficerë. Nëndetësja kishte detyrë luftarake që si nën ujë e mbi ujë të zhytej në thellësinë 200 metra



në thellësi të deteve Adriatik, Jon e Mesdhe. Duhet theksuar se marinarët shqiptarë nuk kishin traditë të lundrimit e të përdorimit të nëndetëseve. Dalja në detyrë luftarake, në atë kohë dhe në kushtet e Luftës së Ftohtë, ishte një ngjarje me përgjegjësi të jashtëzakonshme, dhe më tepër kur komandant ishte i ri. Por të gjithë detarët dhe oficerët e nëndetëses kishin besim te komandanti i tyre për aftësinë, shkathtësinë dhe inteligjencën e pazakontë të këtij oficeri trim, të ditur e atdhetar. Shumë shpejt mori të drejtën e komandimit (vetë-drejtimin) të nëndetëses nga komanda e përbashkët e shtabit sovjetik e shqiptar të Brigadës së Nëndetëseve. ...Shokët e tij e vlerësojnë për buzëqeshjen, të dashur dhe hokatar, por mbi të gjitha për humorin brilant si ai dhe kurrkush tjetër... Ai, duke qenë kërkues e korrekt në detyrë, por veçanërisht në detyrë luftarake dhe në lundrim, ka bërë që gjithmonë të ishte i vlerësuar dhe i dëgjuar nga masa e gjerë. Tek Petrit Myftiu gjeje gjithmonë një lidhje dhe komunikim shoqëror e miqësor me të gjithë detarët e oficerët, me qytetarët e Orikuimit dhe të Vlorës, me fshatarët përreth repartit ushtarak. Ai gjithashtu mbaroi me rezultate të larta Universitetin e Tiranës, në Fakultetin



e Shkencave të Natyrës, për degën matematikë-fizikë.

...Komandant Petriti shkëlqeu dhe si një trim, atdhetar e diplomat i spikatur me përbalimin e provokacioneve të sovjetikëve të ngjarjeve historike të Pashalimanit në vitet '60-të të shek. XX. Në detyrën ushtarake të komandantit Petrit Myftiu është vlerësuar për kujdesin në përgatitjen dhe lartësimin e kuadrove të nëndetëseve, por dhe të shtabit të brigadës, ku shfaqti talent të dukshëm dhe përkushtim të rrallë. Si komandant atë e gjeje kudo, në nëndetëse, në zyrë, në shtab e komandë, në kabinete, në stërvitje komando-shtabi, në lundrime, në detyra luftarake deri në Gjirin e Sirtres, si dhe në kohën e lirë në biseda dhe në aktivitete sportive etj. Në punën dhe në detyrën e tij, ai kishte mbështetjen dhe përkrahjen e kolegëve të tij të nderuar si Aleko Pojani, Skënder Doçi, Beqir Gërbi e Jak Gjergji.

Me një stil për t'u pasur zili, me një korrektësi historike, me një krijimtari mbresëlënëse, ka botuar 4 libra historikë. Të gjithë librat paraqesin nivelin artistik e historik jetësor, duke fituar një emër të nderuar dhe në detin e letërsisë, ku është zhytur si me nëndetësen në thellësinë e kujtimeve të jetës së tij e të shokëve marinarë.




KOLONEL HYSNI GJERGJI

BALONAT, rikthim në betejën e luftës për informacionin

Fillimi i vitit 2023 risolli në vëmendje balonat, këto instrumente të vjetra të luftës në përgjithësi dhe spiunazhit në veçanti. Balonat rezultojnë të jenë efikase në luftën aktuale të grumbullimit të informacionit, megjithëse shekulli XXI, i përket epokës digjitale me satelitët dhe inteligjencën artificiale. Balonat në këtë rast kanë bërë “maskimin” e teknologjisë shumë të avancuar kineze me një veshje të vjetër, siç janë balonat. Balonat nuk i zëvendësojnë satelitët dhe as disiplinën e inteligjencës teknike. Ata janë efikase në spektrin e tyre të operimit dhe mund të mbartin instrumente të tjerë digjitalë spiunazhi, të montuar në trupin e tyre. Ato mund të vëzhgojnë zona të mëdha në lartësi të ulëta dhe me imazhe me rezolucion më të lartë sesa satelitët. Balonat e pajisura me radarë dhe kamera janë përdorur edhe më parë për spiunazh nga SHBA-të dhe ish-Bashkimi Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë. Balonat janë konsideruar një instrument zbulimi me kosto të ulët dhe praktik, që operojnë në 24 000 metra - 37 000 metra lartësi, e cila është shumë më lart se korridorët e trafikut ajror civil, të cilët nuk fluturojnë më lart se 12 000 metra.

Balona e rrëzuar në SHBA, me urdhër të presidentit Biden, nuk është një rast i izoluar dhe balonat kineze nuk u shfaqën vetëm në hapësirën ajrore të SHBA-së. Avionët luftarakë amerikanë e rrëzuan balonën mbi brigjet e Karolinës së Jugut, më 4 shkurt 2023. Zhytësit vazhdojnë kërkimet për mbetjet e saj, për të rindërtuar pajisjet teknike të balonës dhe për të saktësuar teknologjinë e saj të spiunazhit. Ministria e Punëve të Jashtme kineze e konfirmoi fluturimin e një balone kineze edhe mbi Kolumbi, më 06.02.2023.

Duke studiuar historinë e spiunazhit dhe instrumenteve të tij teknikë, në luftërat e mëparshme, gjejmë se francezët janë përdoruesit e parë të regjistruar të balonave të zbulimit, të iniciuar në Betejën e Fleurus kundër trupave austriake dhe holandeze në 1794. Balonat u përdorën gjithashtu në vitet 1860, gjatë luftës civile amerikane, kur ushtarët e Unionit me balona me ajër të nxehtë, të pajisur me dylbi, përpiqeshin të mblidhnin informacione për veprimtarinë e Konfederatës më larg. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtria japoneze u përpoq të hidhte bomba me lëndë djegëse në territorin e SHBA-së, duke përdorur balona të dizajnuara që planeronin në rrymat ajrore. Në vitin 2019, edhe ushtria amerikane përdori mbi 25 balona eksperimentale me energji diellore në lartësi të madhe, për të kryer teste vëzhgimi në një zonë të gjerë në gjashtë shtete. Balonat ishin të pajisura me radarë të teknologjisë së lartë të krijuar për të gjurmuar njëkohësisht shumë automjete ditën ose natën, në çdo lloj moti, dhe synonin të përdreshin për të monitoruar trafikun e drogës dhe kërcënimet e tjera



mundshme të sigurisë së vendit.

Balonat nuk ofrojnë të njëjtin nivel vëzhgimi dhe mbikëqyrjeje të vazhdueshme si satelitët, por janë më të lehtë për t'u lëshuar në hapësirë dhe me kosto më të lirë për t'u ndërtuar. Ekspertët ushtarakë sugjerojnë se përdorimi i balonave në lartësi të mëdha, për grumbullim informacioni, ka të ngjarë të rritet në të ardhmen për arsye të disa specifikave që ata kanë. Ata janë më të vështira për t'u dalluar nga radarët ashtu dhe për t'u rrëzuar, pasi ndonjëherë balonat qëndrojnë për disa ditë në atmosferë edhe pasi janë shpuar. Ata mund të “vetë drejtohen”, duke ndryshuar lartësitë, pasi përdorin kompjuter për të llogaritur se si të përdorin erërat që shkojnë në drejtime të ndryshme, në shtresa të ndryshme të atmosferës.

Satelitët spiunë, që janë gjithë kohës 24/7 mbi ne, zakonisht operojnë në një nga dy llojet e ndryshme të orbitës. E para, në orbitën e ulët e Tokës janë satelitët relativisht afër tokës, deri në disa qindra kilometra mbi ne. Për imazhe dhe fotografi sa më afër të jemi, aq më qartë mund ta shohim fotografinë dhe kjo vlen edhe për disiplinën IMINT të inteligjencës. Satelitët që janë në orbitën e ulët të Tokës kanë avantazhin se duke qenë më afër, janë në gjendje t'i shohin objektet më qartë dhe saktë se sa satelitët që operojnë më lart. Disavantazhi që kanë këta satelitë është fakti që i duhen rreth 90 minuta për të bërë një orbitë të plotë rreth Tokës. Ky rrotullim rezultoi të jetë mjaft i shpejtë për sa i përket marrjes së fotografive të qarta, të objekteve që ndodhen në një pozicion të caktuar në tokë.

Niveli i dytë i orbitës satelitore orbita gjeosinkrone është shumë më lart. Ka disavantazhin se është më e vështirë t'i shohësh objektet qartë kur je shumë lart, por ata kanë avantazhin e vazhdimësisë, duke lejuar satelitët të kapin imazhe në mënyrë të pandërprerë, të vazhdueshme dhe sinkrone. Balonat, ndryshe nga satelitët, operojnë në një tjetër lartësi, gjë e cila i mundëson të skanojnë shumë territor me saktësi të madhe nga një lartësi më e ulët. Ato

kalojnë më shumë kohë në një zonë të caktuar dhe lëvizin më ngadalë se satelitët. Përparësitë e balonave ndaj satelitëve, përfshijnë aftësinë për të skanuar pjesë të gjera të objekteve në territor nga më afër, duke qenë në gjendje të qëndrojnë pothuajse pezull, pa lëvizur mbi një zonë “shënjestër” spiunazhi.

Nuk ka kufij për llojin e teknologjisë së zbulimit që mund t'i montohet balonës. Një ballon bashkëkohor spiunazhi mund të mbartë një përgjues telekomunikimi, IMINT, TELINIT, SIGINT, një video regjistruar, aparat fotografik, madje bomba dhe raketa. Pajisjet e bashkangjitura në balona mund të përfshijnë edhe radar që ushqehet me energji diellore, duke e rritur pavarësinë e operimit për një kohë shumë më të gjatë. Këto pajisje montohen në ballon, i cili planeron mbi një zonë të caktuar, duke përdorur rrymat e erërave, për të kërkuar, ndjekur, filmuar ose fotografuar, si dhe duke kaluar nga një objektiv tek një tjetër.

Kina njoftoi shtypin shtetëror, më 6 mars 2023, projekt-buxhetin për vitin 2023, ku buxheti vjetor i mbrojtjes i vendit të rritet në 7,2 %, që do të thotë 1.5537 trilion juanë ose 224.79 miliardë dollarë. Në vitin 2023, Ushtria Popullore e Kinës do të pajiset me avionë luftarakë më të avancuar, duke përfshirë J-20 dhe J-16 me shumë funksione, në një kohë kur avionët luftarakë të trashëguar J-7 janë duke u larguar nga armatimi.

Sa më lart, ekspertët të sigurisë mendojnë, (dhe unë bashkohem me ta) se në rastin e balonave mbi SHBA, kinezët donin që ato të kapesin nga SHBA-ja. Kapja ndoshta ishte qëllimi i tyre për dy arsye: Arsyeja e parë që u lëshua balona, ishte për të vënë në sfidë SHBA-në, dhe aq më mirë nëse gjatë këtij demonstrimi do të kapte imazhe me vlerë për spiunazhin kinez. Qëllimi i dytë, mund të ishte të ndërjegjësojë SHBA-në për faktin se, Kina e posedon teknologjinë e ballonit spiun. Agjencitë kineze të sigurisë dhe spiunazhit industrial, janë mjeshtrorë në teknologjinë e kopjimit sipas parimit “çdo gjë që ju mund të shpikni, ne mund ta bëjmë edhe

më të mirë se sa ju”. Kina ka plejadën e saj të satelitëve ushtarakë, që janë shumë më të sofistikuar dhe më efektivë për sa i përket vëzhgimit të SHBA-së. Për arsye të konkurrencës midis SHBA-së dhe Kinës, në dominimin e globit nga lart, hapësira tani është e mbushur me satelitë, duke e bërë atë të cenushme. Zona e sipërme atmosferike, paraqet vlerë dhe rëndësi të madhe për vëzhgimin dhe spiunazhin ndërkombëtar, që është kthyer në qendër të luftës informative.

Balonat kineze nuk janë një fenomen i pazakontë, pasi janë parë shumë herë në Azinë Lindore. U shfaqën katër herë në hapësirën ajrore të Tajvanit në shkurt dhe mars të vitit 2022. Pentagoni ekzaminoi pajisjet e mëdha të varura nga balloni i rrëzuar mbi oqean, rreth 70 metra, ku zbuloi se ai kishte aftësi për të kryer “operacionet e grumbullimit të sinjaleve të inteligjencës SIGINT”. Pentagoni priti derisa balona të kalojë tokën për ta rrëzuar atë në detin Karolinës së Jugut të shtunën, duke kërkuar të shmangë vdekjen dhe dëmtimin e pronës në këtë zonë. Balona kishte panele diellore mjaft të mëdha për të furnizuar me energji elektrike, sensorë të fuqishëm të mbledhjes së informacionit.

Pati madje edhe ironi nga qeveria kineze dhe shumë gazetarë, duke e nënvlerësuar këtë instrument lufte. Kjo përgjigje përçmuese, u bë për të fshehur të vërtetën dhe rrezikshmërinë, që ky instrument luftarak i përdorur në shekuj, vazhdon edhe sot të përdoret, më i sofistikuar por edhe dhe më i mohueshëm. “China Daily” deklaroi se pretendimet për balonën spiunë ishin një gënjeshtër. “Për të spiunuar SHBA-në me një ballon, duhet të pranojmë që të dy shtetet, kanë mbetur shumë prapa për të përdorur një teknologji të viteve 1940; ndërsa nga ana tjetër, të jemi mjaft të avancuar për të kontrolluar fluturimin e saj përtej oqeanit.

Tensionet e SHBA-së me Kinën janë të larta, për çështjet që variojnë nga bllokimi i rrjetit 5 G; çështja Tajvanit; deti i Kinës Jugore; të drejtat e njeriut në rajonin perëndimor të Xinjiang, si dhe shtypja e aktivistëve pro demokracisë në Hong Kong. Faktorë të tjerë të acarimit të marrëdhënieve, janë mbështetja e heshtur e Kinës dhënë Rusisë për pushtimin e Ukrainës, refuzimi i saj për të frenuar programin e zgjeruar të raketave balistike të Koresë së Veriut, si dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme mbi tregtinë dhe teknologjinë. Pekini ka kundërshtuar ashpër marrëveshjen midis Filipineve dhe SHBA-së, në të cilën Manila i ka dhënë SHBA-së akses për të zgjeruar bazat e saj ushtarake. Sipas marrëveshjes, SHBA do të ketë akses në bazat filipinase për trajnime të përbashkëta, ruajtjen e pajisjeve dhe furnizimeve si dhe ndërtimin e objekteve ushtarake.

Balona kineze e rrëzuar, vërtetohet se po kryente një operacion zbulimi kundër objekteve ushtarake amerikane, pavarësisht se e dinin se do kapej.

Balona fluturoi pranë bazës ajrore amerikane në shtetin Montana, ku ruhen raketat ndërkontinentale me kokë bërthamore. Për këtë provokim, Europa dhe veçanërisht Gjermania, janë të shqetësuar për tensionet në rritje midis Pekinit dhe Uashingtonit. Deputeti i SPD-të, Michael Roth, beson se “çështja balona” është shkëndija e parë e konfliktit të ardhshëm midis Kinës dhe SHBA-së, që mund të përshkallëzohet në vitet e ardhshme. Sipas një raporti të televizionit gjerman ZDF, theksohet se gjatë mandatit të Donald Trump si president i SHBA-së, tri balona të tilla kanë kaluar pa u penguar mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Objekte të ngjashme janë parë edhe vitet e fundit, por balona e fillim vitit 2023, fluturoi dhe qëndroi mbi territorin amerikan më gjatë se zakonisht.

Objekte të ngjashme fluturose nga Kina janë zbuluar gjithashtu dy herë në Japoninë veriore në vitin 2020. Pas njoftimit të Pentagonit për shkeljen e hapësirës ajrore të SHBA-së edhe qeveria e Kanadasë tha se edhe ai kishte zbuluar një ballon vëzhgimi në lartësi të madhe. Ushtarakët amerikanë deklarojnë se balona e rrëzuar më 3 shkurt kishte udhëtuar mbi territorin e Kanadasë, në rrugën e saj për në Montana dhe se ajo nuk ka hyrë “pa dashje” në hapësirën ajrore të vendeve të Amerikës Latine.

Sensorët e balonës së rrëzuar kineze, janë gjetur në Oqeanin Atlantik. Ekipi i kërkimit gjeti disa mbetje nga vendi, duke përfshirë të plotë “sensorin kryesor dhe pjesët elektronike të vendosura”. FBI po shqyrton pjesët e pajisjeve, që besohet të jenë përdorur për vëzhgim në baza sekrete ushtarake. Balona erdhi nga Kina dhe po përdorej për spiunazh, por Pekini këmbëngul se ishte thjesht për monitorimin e motit, që kishte hyrë gabimisht në territorin amerikan. Që nga incidenti i parë, avionët luftarakë amerikanë kanë rrëzuar edhe tre objekte të tjera mbi Alaskë, territorin Yukon të Kanadasë dhe liqenin Huron në kufirin SHBA-Kanada. Balona e rrëzuar mbi Karolinën e Jugut ishte sa madhësia e tre autobusëve. Objekti i dytë, mbi Alaskë, u përshkrua nga zyrtarët si madhësia e një “veture të vogël”. Objekti i tretë, mbi Yukon, ishte “cilindrik” dhe i katërti, mbi Michigan, thuhej se ishte më e vogël, në formë “tetë këndore”.

Balona spiunë në SHBA, më 3 shkurt 2023, ishte vëzhguar, ndjekur dhe monitoruar që në kohën kur u fut në hapësirën ajrore të SHBA-së, në lartësi të madhe disa ditë më parë. Ajo është monitoruar me disa metoda, duke përfshirë avionët me dhe pa ekuipazh, dhe së fundmi është gjurmuar nga afër kur ka kaluar mbi Montana, ku SHBA-të kanë baza të raketave bërthamore. “Mbështjellja” e pajisjeve moderne të spiunazhit me veshje të vjetër, siç është rasti i balonës, nuk do të thotë kthim mbrapa në teknologji, por kamufllim i formave, mjeteve, objektivave dhe i metodave të reja të spiunazhit ushtarak dhe industrial.

Pirro i Epirit, legjenda ilire

Pirro i Epirit ishte një nga gjeneralët më të shquar të asaj kohe dhe mbret i Epirit dhe i Molosisë. Ai vinte nga fisi ilir i epiroteve.

Ndihmues dhe aleat i popujve italianë që ishin në luftë me Romën.

Ushtarët e tij e thërrisnin "shqiponjë".

U bë i famshëm kur në vitin 280 p.e.s. kaloi ngushticën e Otrantos me 20 000 këmbësorë, 3000 kalorës dhe rreth 200 elefantë, për të luftuar kundër Romës, që rrezikonte qytetin e Tarantos.

Në krye të ushtrive të përbëra nga molosët, tesprotët dhe kaonët, Pirro arriti fitore të dhimbshme kundër ushtrive romake.

Në kulturën perëndimore sot shprehja "Fitorja e Pirros" nënkupton një fitore me sakrificë të mëdha.

Në vitin 307, në moshën 12-vjeçare, Pirro u kthye në Epir me ndihmën e Glaukut dhe u bë mbret.

A është Pirro grek?

Që Pirro nuk është grek, ka shumë të dhëna që e vërtetojnë:

- Nëse do ishte grek, do shkruhej para dhe pas Krishtit – Pirro i Greqisë dhe jo Pirro i Epirit. Sa e thjeshtë dhe e kuptueshme është origjina e tij.

- Gjithashtu Epiri, sipas gjithë shkrimeve të lashta pas Krishtit, ka qenë tokë e fiseve pellazge të kaonëve, tesprotëve, molosëve dhe sot është tokë e labëve, çamëve (dihen qëndrimet e shtetit dhe kishës greke me masakrat çnjerëzore ndaj popullsisë autoktone tesprote dhe molose, gjatë këtyre 200 viteve) dhe janinjotëve me rrethinat e saj.

Epiri, Arbëria dhe Dardania, tre krahina të mëdha, kanë qenë të zotëruara nga banorë autoktonë pellazgë, sot quhen shqiptarë. Nuk mundet të pretendohet se popullsia e sotme në këto troje është 100% e një etnie, por 100 qind për qind këto troje kanë qenë të këtyre fiseve



pellazgo-iliro-epirote dhe jo greke.

- Që Mbreti Pirro nuk është grek, veç studimeve shkencore, historisë, kemi dhe disa fakte, logjike, konkrete. Ashtu siç thuhet, ai kur ishte foshnjë u dërgua për t'u mbrojtur te mbreti Ilir, në Durrës dhe jo, fjala vjen në Athinë, te grekët. Tjetër, gjithë pikënisjet apo vendi ku mbështetej ishte Epiri dhe jo Greqia, etj.

I lëmë studimet shkencore dhe historinë, sepse trajtimet e tyre, dihen nga të gjithë që Pirro ishte djalë dhe

mbret i Epirit. Këto nuk i lënë shteg asnjë abuzimi për identitetin e tij, duke pasur parasysh mospërfilljet e tjetërsimit të tij nga manipuluesit, mashtruesit, të cilët shikojnë errësirë ditën dhe mynxyrë natën.

- Në Tesproti, sot Çamëri, ndodhet fshati Rizian (Rrëzani). Kjo qendër banimi është një nga 7 qendrat e para, më të lashta të Tesprotisë. Sipas kërkimeve të kryera në vitin 2004, nga një qendër arkeologjike franceze, Rrëzani rezulton që nga

neoliti i mesëm.

Para vitit 1944, Risiani kishte rreth 90 shtëpi. Ishte i ndarë në 7 mëhalla (lagje). Njëra prej tyre emërtohej "Mahallaj i Pirrenjëve", sepse banorët e saj rridhnin nga fisi i Pirros.

Ai njihet si strateg e gjeneral i papërsëritshëm në fushat e betejave. Askush nuk di të thotë se në cilën gjuhë Pirro komunikonte me ushtarët e njerëzit e vet, dihet vetëm që ai kishte një lidhje të fortë me gjakun ilir.

Ai ishte kushëri i Olimpias, nënës së

Aleksandrit të Madh, ndërsa një lidhje tjetër me ilirët ishte edhe fakti se ai, qysh fëmijë, ishte rritur në oborrin e Mbretit Glauk të Taulantëve, një prej fiseve më të mëdha ilire, zotërimet e të cilit, në kohë të ndryshme, kapnin hapësirën mes lumit Neretva (Bosnje-Hercegovinë) dhe Vjosës.

Por Pirro i Epirit nuk njihet vetëm për bëmat e tij si strateg ushtarak i antikitetit.

Historia ka lënë pas edhe të dhëna që thonë se ai ishte një mbret i dhënë pas dijes dhe, sa duket, edhe i kujdesshëm për popullin e vet.

Dëshmohet se një pjesë të rregullave, apo normave, të cilat udhëhiqnin veprimtarinë e tij të përditshme, ai i kishte gdhendur në një byzlyk, që mbante në dorë, për t'i pasur gjithmonë përpara mendjes.

Këtë fakt e zbulon apo e sjell për herë të parë Gjon Muzaka, i quajtur Princ i Epirit, një nga aleatët dhe bashkëluftëtarët e Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Ai e ka përfshirë përmbytjen e shkrimeve në unazën e Pirros në testamentin që u ka lënë pasardhësve, të tij në vitin 1510, pak vite përpara se të vdiste.

Për herë të parë testamenti i tij është publikuar i përkthyer në shqip në nëntor të vitit 1931 në revistën "LEKA" (nr.11), që shtypej në Shkodër.

Ja përkthimi i plotë nga italishtja i pjesës që flet për rregullat që Pirro i Epirit mbante të shkruara në unazën e vet:

- Të fortin nuk e shpërblen sa duhet edhe sikur botën mbarë t'i japësh, të dobëtin nuk e ndëshkon sa duhet, edhe sikur vetë jetën t'ia marrësh.
- Është më i nderuari ndër të nderuarit ai që goditet prej fatit, pa pasur faj, dhe është më i poshtri ndër të poshtër ai që përkëdhelet nga fati pa e merituar.

- Atë çka mund ta bëni me të mirë, mos e bëni me të keq.

- Atë që mund ta arrini me paqe, mos e kërkoni me luftë.

- Atë çka mund ta fitoni duke e kërkuar, mos e humbni duke kërcënuar.

- Atë çka mund ta ndreqësh pa bërë zhurmë, mos e ekspozo në publik.

- E ka bërë mirë detyrën ai prind, që lë pas një fëmijë të ditur por të varfër dhe nuk e ka bërë detyrën ai tjetri, që lë pas një fëmijë të pasur por budalla.

- Ka më shumë vlerë një ndihmë e vogël, por e ardhur në kohë, se sa një e madhe, por që mbërrin me vonësë.

- Njeriu që arrin të bëhet tiran i madh me forcë, meriton të kthehet në skllav me drejtësi.

- Nuk mjafton që një person të jetë i mirë, është e domosdoshme që ai të ndreqë gjërat që kanë marrë për keq.

- Në këtë jetë, njeriu duhet të verë në punë mendjen, sepse lumturia është një mall hua, kurse fatkeqësia është pasuria e natyrshme e tij



Bajram Curri, historia e vlerë e kombit shqiptar

*O Bajram, bajrak i gjallë,
More nam me gjak në ballë,
Te një shpell' e Dragobisë,
Yll i rrall' i burrërisë.*

*Thon' u-shtri e thon' u-vra,
Po ti s'vdique, or Baba,
As te shkëmb' i Dragobisë,
As te zëmr' e Djalërisë.*

*As je vrrar' e as po vrutesh
Legjendar Ante po rrutesh.*

*Diñhiramb i Dragobisë,
Tmerr, panik i mizorisë.*

*Me Zjarr Shenjt u-nërit
kjo shpellë.*

*Gjer në qjell u-ngrit Kështjellë
Për çlirimn' e Shqipërisë*

Katakomb' e Dragobisë

Bajram Curri në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare

Me origjinë nga fisi i njohur i Krasniqes (Malësia e Gjakovës), i lindur në Gjakovë, Bajram Curri u shqua si veprimtar i lëvizjes kombëtare të periudhës së Rilindjes, duke qenë një ndër udhëheqësit politikë e ushtarakë të kryengritjeve popullore kundër-osmane dhe të luftës për çlirimin e bashkimit kombëtar të vendit.

Ishte një ndër organizatorët e Lidhjes Shqiptare të Pejës (1899-1900) dhe veprimtar i saj për autonominë e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit, drejtues kryesorë në kryengritjet kundër-osmane në periudhën 1908 – 1912, që u finalizuan me shpalljen e pavarësisë. Pas vitit 1912, luftoi në Kosovë për mbrojtjen e saj nga pushtuesit serbë. Nuk u pajtua me vendimet e Konferencës së Londrës së 1913, që shkëputën Kosovën dhe treva të tjera shqiptare, lindore e jugore, nga shteti i pavarur shqiptar. Në vitin 1918 u zgjodh anëtar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe qe një ndër udhëheqësit kryesorë të tij.

Në një portretizim të Bajram Currit, At Zef Valentini do evidentonte:

“Bajramit ia kish anda, tue kujtuem emnin e gjinisë së vet, Curraj, me i thënë vedit: Un jam Curr! Në ndërtesën shpirtnore të Shqipnis, themelet do të vihen prej currash, prej virtytesh karakteristike të fisit; kur këta të qëndrojnë, edhe Shqipni ka; kur këta të hiqen, Shqipni i luhet “carani i votrës.”

Kontribute për konsolidimin e Shtetit Shqiptar

Në kongresin e Lushnjës, Bajram Curri u zgjodh anëtar i Këshillit Kombëtar, i cili e caktoi ministër pa portofol në qeverinë e Sulejman Delvinës.

Në vitet 1920-1921, me cilësinë e komandantit të Operacionit, bashkëpunoi me ministrin e Brendshëm, Ahmet Zogun, për të realizuar vendosjen e autoritetit të shtetit shqiptar në tërë territorin e Shqipërisë së njohur nga Konferenca e Londrës 1913. Me dekret nr. 846, datë 30 maj 1920, të Këshillit të Ministrave, Bajram Curri u emërua



ME ORIGJINË NGA FISI I NJOHUR I KRASNIQES (MALËSIA E GJAKOVËS), I LINDUR NË GJAKOVË, BAJRAM CURRI U SHQUA SI VEPRIMTAR I LËVIZJES KOMBËTARE TË PERIUdhës SË RILINDJES, DUKE QENË NJË NDËR UDhËHEQËSIT POLITIKË E USHTARAKË TË KRYENGRITJEVE POPULLORE KUNDËR-OSMANE DHE TË LUFTËS PËR ÇLIRIMIN E BASHKIMIT KOMBËTAR TË VENDIT.

komandant i Operacionit kundër Lëvizjes së Shqipërisë së Mesme, më 30 qershor 1921, Bajram Curri emërohet komandant i Operacionit kundër lëvizjes së Marka Gjonit në Mirditë.

Veprimi i armatosur kundër institucioneve të Shtetit Shqiptar
Zhvillimet politike konfliktuale, ku nuk munguan dhe lëvizjet e armatosura, i pozicionuan në kampe të kundërta Ahmet Zogun dhe Bajram Currin. Tradita gojore evidenton si shkak të ftohjes së tyre edhe martesën e Ceno Beg Kryeziut me motrën e Ahmet Zogut, familjet Curri dhe Kryeziu kishin trashëguar një histori konfliktesh ndërmjet tyre.

Nga marsi 1922, Bajram Curri zgjodhë rugën e veprimit të armatosur kundër institucioneve shtetërore shqiptare. Ishte një ndër protagonistët kryesorë në lëvizjen e vitit 1923 dhe në Revolucionin e Qershorit 1924. Pas Triumfit të Legalitetit (24 dhjetor 1924), u tërhoq në Krasniqe, duke qëndruar si mik i bajraktarit të Krasniqes, Sali Mani, nga ku vazhdoi

përpjekjet e tij të dëshpëruara për organizimin e një lëvizjeje të re kundër pushtetit legjitim në Tiranë.

Vetëvrësja e Bajram Currit

Më 2 janar 1925, Bajram Curri mbledhi parinë e Krasniqes dhe një ditë më pas u deklarua besa e Krasniqes për të kundërshtuar çdo mësymjeje qeveritare. Më 8 janar, rreth agimit, forcat e Currit nga Krasniqja mësyjnë Gashin e mbas një luftimi, ku mbetën 10 të vdekur e një i plagosur nga forcat qeveritare dhe një i vrrarë e një i plagosur nga mbështetësit e Currit, Bajram Curri merr vetëm Tropojën, qendrën e Gashit. Më 9 janar, fuqia e Currit nga Tropoja nis për në Bytyç, duke pasur për objektiv Krumën, qendrën e Prefekturës së Kosovës, ku kishte nisur dhe forca të tjera nga Krasniqja, duke paraqitur kështu një kërcënim serioz për stabilitetin e shtetit.

Për të shuar këtë rebelim të ri në Veriun e Shqipërisë, presidenti i Republikës Ahmet Zogu, me cilësinë e kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Brendshme, kishte emëruar komandant Operacioni për Veriun Ceno Beg

Kryeziun. Ndërkohë, vëllai i Cenos, Hasan Kryeziu, ushtronte detyrën e prefektit të Kosovës (Kukës, Has, Tropojë).

Në kushtet që situata po rëndoej nga ora në orë, duke vlerësuar potencialin e Bajram Currit për lëvizje të armatosura, me telegramin rezervat, nr. 19, datë 8 janar 1925, urdhërohet Komanda e Operacionit të Veriut që “kundër Bajram Currit të përdoren masat më të rrepta e definitive, që kështu të mos ketë nevojë më me bën operacione në ato vise ...”. Një ditë më pas, më 9 janar, Ceno Begut iu dërgua telegrami tjetër urgjent nga kryeministri Ahmet Zogu me urdhrin: “Currin gjallë a vdek duhet ta zini dhe fuqinë e tij duhet ta shkatërroni krejt, tue marrë gjithë masat që kështu të shuhet revolucioni i Kosovës e të mos përsëritet më.”

Irrethuar nga forcat e xhandarmërisë dhe pa shpresë shpëtimi, Bajram Curri vrau veten më 29 mars 1925, në një shpellë në Grykën e Dragobisë (Tropojë). Më 30 mars 1925, nga bjeshkët e Dragobisë, komandanti

i kompanisë së xhandarmërisë që realizoi operacionin, nëntoger Kadri Malësia (Mustafa), njoftoi telegrafisht Tiranën: “U lajmërojmë se në një luftë të përgjakshme i arratisuni, i quejtuni anmik i shtetit shqiptar Bajram Beg Curri u vra dekun dhe i arratisuni Shefqet Draga u zu rob. Edhe shtatëdhjetë armë të fshehuna i mora. Në këtë luftë mbetën dekun 5 gjindarmë e katër të plagosun. Nalt i dekuni ish kenë me të gjithë të arratisunit. Kryetar i luftës kundra ushtrisë [ishite] bajraktar Sali Mani. Rrnoftë Republika Shqiptare!”

Më 31 mars, Ministria e Brendshme u telegrafoi prefekturave, nënprefekturave dhe gazetave qendrore dhe lokale duke i informuar për ngjarjen. Në fund të telegramit theksonte:

Më 1 prill 1925, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Kostaq Kotta i dërgoi këtë telegram falënderimi Prefekturës së Kosovës, i cili iu përcoll dhe Zyrës së Shtypit për publikim: “Kjo ministri e konsideron detyrë morale t’ju falënderojë për kujdesin dhe aktivitetin që treguat në vrasjen e Bajram Currit dhe lus kurdoherë sukses në detyrë të titullarit t’asaj Prefekturë, z. Hasan Kryeziu.”

Po më 1 prill 1925, në vlerësim të kontributit për vendosjen e rendit në Veriun e Shqipërisë, presidenti i Republikës Ahmet Zogu emëroi Ceno Beg Kryeziun ministër të Punëve të Brendshme. Për këtë i erdhën telegrame urimi nga të gjitha prefekturat dhe nënprefekturat, si dhe nga populli, ku i shfaqeshin urimet dhe gëzimet e tyre të nxehta.

Një teknologji kontradiktore rakete mund të sfidojë një ligj bazë të fizikës

Një nga aspektet më emocionuese të epokës aktuale të eksplorimit të hapësirës (Space Age 2.0) është se si më në fund po realizohen idetë e sanksionuara në kohë.

Disa nga shembujt më të njohur përfshijnë raketa të rikuperueshme dhe të ripërdorshme, rikuperim në det, rikthim në ajër, raketa me një fazë në orbitë (SSTO) dhe sisteme kinetike të lëshimit.

Përveç kësaj, ka gjithashtu përpjekje për të zhvilluar sisteme shtytëse që nuk mbështeten në shtytës konvencionale. Kjo teknologji ofron shumë përparësi, duke përfshirë masën më të ulët dhe efikasitetin e përmirësuar të energjisë, duke ulur përfundimisht kostot.

Një sistem shtytës për satelitët, tërësisht elektrik, do të fluturojë në hapësirë për herë të parë. Sistemi u ndërtua nga kompania e energjisë pa tela me bazë në Dakotën e Veriut IVO, Ltd., dhe do të shërbejë si një shtrat testimi për një teori alternative të inercisë, që mund të ketë aplikime për shtytje.

Motori do të lëshohet në majë të një rakete "SpaceX - Falcon 9". Nëse teknologjia vërtetohet, Quantum Drive mund të shkaktojë një revolucion në hapësirën tregtare dhe më gjerë. Dhe nëse jo, atëherë mund të relaksohemi duke ditur se ligjet e fizikës janë ende ligjet e fizikës!

Transport i qëndrueshëm në hapësirë

Nuk është sekret se bota po kalon një tranzicion të madh në aspektin e energjisë, transportit, prodhimit dhe infrastrukturës. Përveç përparimeve në kompjuter, printim 3D dhe inteligjencë artificiale, një forcë kryesore lëvizëse pas këtyre ndryshimeve është dëshira për alternativa më të pastra dhe më të qëndrueshme.

Kjo ka çuar në risi si interneti pa tel dhe pajisjet, makinat elektrike, stacionet e karikimit të EV dhe qelizat diellore të miniaturës dhe turbinat e erës. Fatqësisht, këto risi mbështeten në bateritë toksike dhe teknologjitë e pasigurta të karikimit.

E themeluar në vitin 2017 nga Richard Mansell, Ken Mansell, Daniel Telehey dhe Matthew Silbernagel, IVO u lançua për të adresuar çështjet kryesore me të cilat përballet teknologjia dhe inovacioni sot. Për këtë qëllim, IVO është fokusuar në zhvillimin e zgjidhjeve të transmetimit të energjisë pa tel, duke përdorur një teknologji të njohur si Transmetimi Ajror me Bazë Kapacitive (CBAT).

Kjo teknologji fleksibël dhe e shkallëzueshme i lejon prodhuesit të zvogëlojnë madhësinë e baterisë së tyre deri në 50 për qind dhe është në rrugën e duhur për të prishur industrinë e energjisë së gjelbër.

Përveç kësaj, dekada e fundit ka parë një rritje të mprehtë të numrit të kompanive komerciale të hapësirës, duke çuar në inovacione si raketat e ripërdorshme dhe mikrosatelitët. Për shkak të kësaj, hapësira është bërë shumë më e aksesueshme, me më shumë kombe, kompani dhe institucione akademike që dërgojnë ngarkesa në orbitë.

Mjerisht, industria hapësirë është ende e varur nga shtytësit që janë toksikë (ose prodhojnë nënprodukte toksike) ose prodhojnë sasi të mëdha të gazit serrë. Duke përdorur vajguri dhe lëndë djegëse me bazë metani, lëshimet e raketave mund të lëshojnë deri në 100 herë më shumë CO2 në atmosferë (për pasagjer) sesa një fluturim në distanca të gjata.

Në vitin 2021, IVO filloi të zhvillonte një sistem të ri shtytës tërësisht elektrik



që përdorte një teori alternative për inercinë. I njohur si IVO Quantum Drive, ky sistem i propozuar mbështetet në teorinë e Inercisë së Kuantizuar (QI), një ide e diskutueshme që shumë fizikanë e shohin si një teori skajore.

Një teori alternative e inercisë

Teoria e QI u propozua për herë të parë në 2007 nga fizikani i Universitetit të Plymouth, Mike McCulloch, si një alternativë ndaj modelit Lambda Cold Dark Matter (LCDM).

Kjo teori ishte një përpjekje për të pajtuar Relativitetin e Përgjithshëm (GR) dhe Teorinë Kuantike të Fushës (QFT) për të shpjeguar kthesat rrotulluese të galaktikave në një mënyrë që nuk kërkonte Materien e Errët (dhe si një shpjegim për Anomalinë e Pioneerit). Teoria zbrit në dy elementë thelbësorë:

- Sipas GR, ekziston një horizont ngjarësh në Univers, ku drita nuk mund të arrijë një objekt sepse nxitimi kozmik tejkalon shpejtësinë e dritës. Një horizont i ngjashëm prodhohet nëse një objekt përshpejtohet në një drejtim (i njohur si horizonti Rindler). Çdo gjë përtej kësaj është jashtë Universit të vëzhgueshëm dhe nuk mund të ndikojë në objektin në qendër të "hapësirës Rindler".

- Sipas QFT, rrezatim i ngjashëm parashikohet për një objekt përshpejtues (rrezatimi Unruh). QI parashtron se rrezatimi Unruh është origjina e inercisë. Ngjashëm me Alcubierre Metric (por në një shkallë më të madhe), horizonti i informacionit "Rindler" zgjerohet në drejtim të nxitimit dhe tkurret pas tij.

McCulloch gjithashtu pohoi se kjo teori mund të sigurojë një bazë për lëshimin e automjeteve hapësirë pa karburant. Teoria është sfiduar në mënyrë të përsëritur dhe në vitin 2012, astrofizikanët zgjidhën Anomalinë, duke arritur në përfundimin se emetimi jo uniform i nxehtësisë nga anija kozmike ngadalësoi shpejtësinë e tyre.

Megjithatë, vitet e fundit, McCullough dhe kolegëve të tij iu dha një grant DARPA për të kryer eksperimente për të hetuar QI në një mjedis laboratorik. Me lëshimin e IVO Quantum Drive, teoria do të testohet në hapësirë për herë të parë.

Zhvendosja e kostove

Nëse vërtetohet, një sistem i tillë do

të ofronte avantazhe të shumëfishta ndaj shtytësve konvencionalë, më i dukshëm prej të cilëve është efikasiteti ekstrem. Sipas IVO, një Quantum Drive i vetëm mund të arrijë deri në 52 milinewton (mN) shtytje nga një vat i vetëm i energjisë elektrike të furnizuar vetpërmjet një kombinimi të ruajtjes së energjisë në bord dhe energjisë diellore. Ky do të ishte një përmirësim i konsiderueshëm ndaj shtytësve me efekt Hall (motorët jonikë), të cilët mund të arrijnë 25-250 mN shtytje, kanë efikasitet më të ulët të energjisë (65 deri në 80 përqind) dhe kërkojnë më shumë fuqi - 1-7 kilovat (kW).

Një përfitim tjetër, sipas IVO, është dizajni modular i shtytësit, i cili lejon që njësi të shumta të grumbullohen (dhe në akse të shumta) për të arritur shtytje më të madhe dhe për të përmbyshur nevojat e anijeve hapësirë individuale. Për më tepër, një shtytës tipik Hall-Effect do të peshojë më shumë se 200 kg (440 lbs), ndërsa një njësi e vetme e jashtme dhe e brendshme Quantum Drive peshon vetëm 186,6 gram dhe 103,5 gram (6,6 dhe 3,65 oz), respektivisht.

"IVO Quantum Drive është me të vërtetë një largim total nga kufizimet aktuale të shtytjes moderne hapësirë. Është pajisja e parë shtytëse elektrike e pastër, që do të thotë se kërkon vetëm energji elektrike për të funksionuar. Kohët e sistemeve komplekse të karburantit që kërkojnë zgjidhje të veçanta karburanti për të shtyrë anijen kozmike kanë ikur kanë kaluar. Për sa kohë që kemi energji elektrike, kemi shtytje, kjo është arsyeja pse Delta-V e pakufizuar është e mundur për herë të parë ndonjëherë. Për shkak të natyrës së tij të pavarur, kjo është pajisja e parë shtytëse që mund të jetë plotësisht e brendshme për një anije kozmike", - tha bashkë-themeluesi Telehey, tani Shefi Operativ i IVO Ltd.

Shtytësi i pavarur mund të montohet gjithashtu në çdo orientim, duke ofruar deri në 6 gradë lirie. Eliminimi i shtytësve do të eliminonte gjithashtu nevojën për rezervuarë të rëndë, duke reduktuar masën e përgjithshme të anijes dhe duke rritur kapacitetin e ngarkesës së saj. Së fundmi, një sistem shtytës që nuk kërkon shtytës heq nevojën për karburant satelitor ose deorbitim për shkak të kufizi-

meve të karburantit. Telehey thotë se këto avantazhe "do të nxisin ndryshimin më dramatik në drejtim të uljes së kostos që ka parë ndonjëherë industria hapësirë".

Tashmë, IVO Ltd. ka punuar me E-Labs (një strukturë testimi dhe vlerësimi me bazë në Virxhinia) për të vërtetuar Quantum Drive në një mjedis hapësirë të simuluar.

Për të testuar sistemin e tyre shtytës në hapësirë, IVO Ltd. është bashkuar me zhvilluesin e robotikës orbitale, "Rogue Space Systems". Rogue është duke krijuar gjeneratën e parë të Robotëve Orbital (të njohur si OrbotsTM) për të lehtësuar praninë në rritje të njerëzimit në hapësirë. Familja Orbot aktualisht përbëhet nga Laura Orbot, i projektuar për të inspektuar, monitoruar dhe vëzhguar, dhe Fred, i projektuar për të lëvizur satelitët dhe asetet e tjera në dhe nga orbita të ndryshme. Është planifikuar dhe një anije e tretë kozmike.

Të tre anijet kozmike mbështeten nga një sistem operativ që përfshin mësimin e makinerive dhe aftësinë autonome - Platforma e Vëzhgimit të Sensorit të Aktivizuar nga AI (AESOP). Ky sistem i lejon Orbots të funksionojnë në mënyrë autonome, duke kompensuar vonesat në komunikim dhe periudhat kur anija kozmike nuk është e dukshme për stacionet e kontrollit në tokë. Ai gjithashtu siguron shmangien e përplasjeve dhe gjurmimin e afërsisë, duke lejuar që Orbot të pozicionohet automatikisht pranë një sateliti të synuar dhe të përcaktojë se si ta shërbejë atë siç duhet.

"Partneriteti ynë me 'Rogue Space Systems' buron nga pasioni ynë i përbashkët për inovacionin dhe një objektiv përfundimtar për të zgjeruar aftësitë njerëzore", - shprehet Telehey.

"Njerëzimi i ka parë yjet për mijëra vjet me habi dhe kuriozitet. Tani, për herë të parë në historinë e njerëzimit, ne kemi aftësinë të shtrijmë dorën dhe të prekim këto vende të largëta. Organizatat tona e marrin këtë seriozisht dhe, së bashku, IVO dhe Rogue synojnë të bëjnë histori."

Natyrisht, lajmet e këtij testi dhe pretendimet e kompanisë janë pritur me skepticizëm të konsiderueshëm nga shumë shkencëtarë. Veçanërisht, është Andrew Higgins, një profesor i inxhinierisë mekanike në Universitetin McGill dhe

udhëheqës i Grupit Kërkimor Eksperimental të Fluturimit Ndëryjor. Në vitin 2018, Higgins botoi një punim të titulluar "Pajtimi i një lëvizjeje shtytëse pa reagim me ligjin e parë të termodinamikës", ku ai demonstroi se një makinë elektromagnetike që nuk përdor shtytës nuk ishte fizikisht e shëndoshë.

Sipas Higgins, pajisjet elektromagnetike që nuk mbështeten në shtytës mund të gjenerojnë jo më shumë se 3.33 mikronjuton për kilovat shtytje, ose përndryshe ato përfundojnë të jenë një lloj makinerie me lëvizje të përhershme. Kjo është për shkak se aplikimi i forcës konstante rezulton në nxitim konstant, që do të thotë se energjia kinetike e objektit rritet në mënyrë kuadratikë me kalimin e kohës, ndërsa energjia hyrëse rritet në mënyrë lineare. Si rezultat, energjia kinetike e objektit do të tejkalojë energjinë hyrëse dhe (nëse kjo energji mblidhet përmes ngadalësimit) do të ketë një fitim neto në energji. Shkurtimisht, koncepti shkel Ligjin e Parë të Termodinamikës.

"Përpjekja ime për IVO Quantum Drive është e njëjtë me diskun EM, shtytësin me efekt Woodward Mach ose çdo pajisje tjetër që pretendon se merr një hyrje të energjisë dhe gjeneron dalje shtytjeje, pa ndërveprime të tjera me një masë reaktive ose ndonjë masë tjetër për të shtyrë kundër. Është e parëndësishme të tregosh se një pajisje e tillë mund të shndërrohet në një makinë lëvizjeje të përhershme të llojit të parë. Kjo do të thotë, një makinë që thjesht gjeneron energji nga një kuti e zezë, pa ndërveprime të tjera", - thotë Higgins për "Universe Today".

Si përgjigje, Mansell ka deklaruar se Quantum Drive nuk është një sistem pa reagim dhe nuk është i krahasueshëm me EM Drive. "Teoria e inercisë së kuantizuar ofron disa mënyra unike për të lëvizur anijen pa karburant dhe pa shkelur ligjet e lëvizjes së Njutonit", - tha ai. "Quantum Drive përdor energjinë elektrike dhe konfigurimin tonë të patentës në pritje për të lëvizur anijen kozmike. Ky konfigurim është testuar aq sa mundet në sipërfaqen e Tokës. Testi tjetër dhe përfundimtar do të jetë në LEO."

Bazuar në nivelet aktuale të rritjes, sektori i hapësirës komerciale parashikohet të arrijë një vlerë totale prej 1.4 trilion dollarë deri në vitin 2030. Në mënyrë të ngjashme, sektori i energjisë së gjelbër parashikohet të arrijë në 1.4 trilion dollarë përpara fundit të dekadës.

Këto zhvillime paralele ilustrojnë potencialin e kompanive në hapësirë, ku aksesueshmëria po rritet dhe kërkesa për alternativa më të pastra, më të sigurta dhe më efikase është e lartë. Dhe këtu qëndron thelbi i këtij demonstrimi, i cili është testimi i sistemit dhe fizikës teorike mbi të cilën ai bazohet.

Nëse dështon, shkencëtarët mund të jenë të qetë se ligjet e fizikës nuk kanë nevojë të rishikohen. Nëse ka sukses, do të hapë derën për mundësi të jashtëzakonshme. Në fund të fundit, duket e drejtë të thuhet se të gjithë (pro ose kundër) janë të ngazëllyer për të parë se çfarë vjen prej saj!

Nisja është planifikuar për në 10 qershor dhe do të transmetohet drejtpërdrejt përmes Youtube të SpaceX.

Nga Matt Williams, "Universe Today"

NATO PO MONITORON NGA AFËR SITUATËN

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Retorika bërthamore e Rosisë "e rrezikshme dhe e papërgjegjshme"



"Njoftimi i fundit i Rosisë se do të zhvendosë armët taktike bërthamore në Bjellorusi është i rrezikshëm dhe i papërgjegjshëm. NATO është vigjilente dhe ne po e monitorojmë nga afër situatën. Ne nuk kemi vënë re ndonjë ndryshim të veprimtarisë bërthamore të Rosisë, që mund të çonte në ndryshimin e qëndrimit tonë", - tha në një deklaratë zëdhënësja e NATO-s, Oana Lungescu. "Referenca e Rosisë ndaj ndarjes bërthamore të NATO-s është krejtësisht mashtruese", - tha më tej Lungescu, duke iu referuar pretendimeve të fundit Putinit, se lëvizja e tij thjesht do të pasqyrojë ato të vendeve perëndimore. "Aleatët e NATO-s veprojnë me respekt të plotë të angazhimeve të tyre ndërkombëtare. Rusia ka thyer vazhdimisht angazhimet e saj për kontrollin e armëve, më së fundi duke pezulluar pjesëmarrjen e saj në Traktatin e NEW START", - tha ajo. "Rusia duhet t'i kthehet pajtueshmërisë dhe të veprojë me mirëbesim", - theksoi Lungescu.

Edhe Shefi i politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, dënoi gjithashtu njoftimin e Putinit. Ai i bëri thirrje Bjellorusisë që të mos bëjë strehë e armëve bërthamore ruse. "Bjellorusia që pret armë bërthamore ruse do të nënkuptonte një përshkallëzim të papërgjegjshëm dhe kërcënim për sigurinë evropiane. Bjellorusia ende mund ta ndalojë, është zgjedhja e tyre", - tha Josep Borrell dhe kërcënoi me sanksione të mëtejshme. "BE është e gatshme të përgjigjet me sanksione të mëtejshme", - tha ai.

Por edhe zëdhënësja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Adrienne Watson tha se SHBA po monitoron implikimet e deklaratës së Putinit, por shtoi se: "Ne nuk kemi parë ndonjë arsye për të rregulluar qëndrimin tonë strategjik bërthamor, as ndonjë indikacion që Rusia po përgatitet të përdorë një armë bërthamore. Ne mbetemi të përkushtuar ndaj mbrojtjes kolektive të aleancës së NATO-s".

Lëvizja e armëve bërthamore taktike ruse në Bjellorusi i afron ato jo vetëm me Ukrainën, por me Poloninë, Lituaninë dhe Letoninë, që janë të gjithë aleatët e NATO-s dhe kjo rrit nivelin e kërcënimit në Evropë, diçka që Putini synonte të bënte. Njoftimet për testet e raketave dhe ngjarje të tjera që përfshijnë armë bërthamore kanë qenë një pjesë e rëndësishme e ruajtjes së stabilitetit strategjik për dekada. Ato sigurojnë që as Rusia dhe as Shtetet e Bashkuara të mos keqinterpretojnë lëvizjet e njëra-tjetrës. Traktati vendos kufizime në numrin e armëve bërthamore të vendosura me rreze ndërkontinentale që mund të kenë si SHBA-të ashtu edhe Rusia. Ai u zgjat për herë të fundit në fillim të vitit 2021 për pesë vjet. Sipas traktatit kyç të kontrollit të armëve bërthamore, si Shtetet e Bashkuara ashtu edhe Rusia lejohen të kryejnë inspektime në vendet e armëve të njëra-tjetrës, megjithëse inspektimet ishin ndërprerë që nga viti 2020 për shkak të pandemisë Covid-19.

Armë bërthamore taktike në Bjellorusi, Putini do të shpërqendrojë vëmendjen

Putini kërkon të frikësojë botën dhe ta shpërqendrojë atë nga problemet e tij, kur tha se ka në plan të vendosë armë bërthamore taktike në Bjellorusi, aleatin fqinj nga i cili organizoi një pjesë të pushtimit të tij të Ukrainës në shkurt 2022. Ai e di se kur përdor fjalën "bërthamore", bota i kushton vëmendje, prandaj kjo duket të jetë një arsye kryesore, thanë ekspertët. Por duhet lexuar midis rreshtave dhe duhet kontrolluar konteksti, thonë ata. Armët që Putin planifikon të transferojë në Bjellorusi nuk janë armë bërthamore strategjike, ato janë raketa gjigante balistike ndërkontinentale që, nëse lëshohen, mund t'i japin fund jetës në tokë. Armët bërthamore taktike janë më të vogla, por të fuq-

ishme dhe mund të përdoren në fushën e betejës. Putini ka kërcënuar mundësinë e një lufte bërthamore edhe gjatë vitit të kaluar, ai e bën tani veçanërisht kur operacioni i tij ushtarak në Ukrainë po lëkundet, kjo mund të ndihmojë për të shpjeguar kontekstin e njoftimit të Putinit, i cili për momentin "është njeri me shumë probleme", thonë analistët. Forcat ruse po bombardojnë qytetet e Ukrainës nga ajri, por lufta e tyre tokësore nuk po bën shumë përparim. Përveç disa marrëveshjeve të reja tregtare me Kinën, që së fundmi takimi i Putin me Xi Jinping, e bën Rusinë tani duket të jetë partneri i vogël i Kinës. Nga ana tjetër është Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe urdhri i arrestit që ajo ka lëshuar për Putinin.

Ndërkohë Putin fajëson perëndimin për vendimin e tij, duke justifikuar se ai po vepron si kundërpërgjigje ndaj furnizimit të Ukrainës nga Mbretëria e Bashkuar me municion antitank që përmban uranium të varfëruar dhe ai thotë se ky është një përshkallëzim i rrezikshëm. MB e mohon këtë, duke shpjeguar se municioni përdoret vetëm për qëllime konvencionale. Ndërsa Putin tha se Rusia po ndërton një objekt magazinimi për armët bërthamore taktike që do të jenë gati deri në korrik. Ai tha se Rusia tashmë ka 10 avionë të aftë për të mbajtur armë bërthamore, si dhe disa sisteme raketash me rreze të shkurtër veprimi "Iskander", që mund të mbajnë armë bërthamore. Gjithashtu lideri rus tha se nuk do të transferojë kontrollin e armëve bërthamore taktike te presidenti bjellorus Aleksandër Lukashenko, i cili nga ana e tij ka kërkuar armët prej një kohe të gjatë, ndërkohë që ka nënshkruar një marrëveshje në 1994, ku heq dorë nga armët bërthamore strategjike, që Bjellorusia i kishte në fund të Luftës së Ftohtë. Mbajtja e kontrollit të armëve nga forcat ruse, të cilat, nëse do të vendosen përgjithmonë në tokën bjelloruse, tregon se Lukashenko është edhe më shumë nën kontrollin e Putinit.

Rusia pezullon të gjitha njoftimet bërthamore, SHBA i përgjigjet

Zëvendësimin e Jashtëm rus Sergei Ryabkov tha të mërkurën, më 29 mars, se të gjitha llojet e njoftimeve midis Rosisë dhe Shteteve të Bashkuara në bazë të traktatit të ri bërthamor START janë pezulluar. Sipas medias shtetërore ruse deklarata e Ryabkov përfshinte pezullimin e njoftimeve për lëshimet e raketave provë. Njoftime të tilla mbulohen nga traktati origjinal i

vitit 1988, i cili mbetet në fuqi. Ryabkov tha se "nuk do të ketë fare njoftime. Të gjitha formatet janë pezulluar", - tha ai. "Të gjitha njoftimet, të gjitha format e njoftimeve, të gjitha shkëmbimet e të dhënave, të gjitha aktivitetet e inspektimit, në përgjithësi, të gjitha llojet e punëve sipas kontratës janë pezulluar, nuk do të kryhen. Dhe kjo nuk varet nga pozicioni që Shtetet e Bashkuara mund të marrin", - tha Ryabkov, sipas mediave shtetërore ruse.

Kurse një ditë më parë, zyrtarë të lartë amerikanë e bënë të ditur se Rusia nuk do që t'i japë Shteteve të Bashkuara të dhëna për forcat e saj bërthamore, që ndahen çdo gjashtë muaj në bazë të traktatit kyç të kontrollit të armëve bërthamore. Dhe si përgjigje e kësaj edhe SHBA-të nuk do ta bëjnë këtë, tha zyrtari i lartë i Pentagonit dhe një zëdhënës i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Masa e Moskës për të mos dhënë informacionin vjen pasi Presidenti Vladimir Putin, në shkurt pezulloi pjesëmarrjen e Rosisë në traktatin e ri START, e vetmja marrëveshje dypalëshe e mbetur midis dy fuqive më të mëdha bërthamore në botë.

Ndihmës Sekretari i Mbrojtjes për Politikën Hapësinore, John Plumb tha se SHBA-të i kishin bërë presion Rosisë për shkëmbimin e informacionit, që duhet të ndodhë në fund të këtij muaji. "Dje, ne patëm një ndërveprim të mëtejshëm me Rusinë, duke i shtyrë ato në fundin e muajit të ardhshëm, do të ketë një shkëmbim gjashtëmuajor të të dhënave, çdo gjashtë muaj, sipas traktatit, ne shkëmbejmë të dhëna për një lloj numrash të nivelit të lartë", - tha ai në një seancë dëgjimore të nënkomitit të Shërbimeve të Armatosura të Dhomës së Përfaqësuesve. "Por Rusia u përgjigj se nuk do ta japin informacionin, - tha ai, - dhe kështu, si një kundërmasë diplomatike, Shtetet e Bashkuara nuk do të kthejnë informacionin. Ne do të vazhdojmë të shqyrtojmë se cilat janë kundërmasat diplomatike që janë të përshatshme", - tha Plumb. "Ajo që ne po përpiqemi të bëjmë, është të balancojmë si përgjigje ndaj sjelljes së papërgjegjshme të Rosisë, por edhe të vazhdojmë të demonstrojmë atë që ne besojmë se duhet të jetë veprimi i një fuqie bërthamore të përgjegjshme." Zëdhënësi i NSC e përshkroi vendimin për të mos ndarë të dhëna në përgjigje të veprimit të Rosisë si një kundërmasë të ligjshme që synon të inkurajojë Rusinë të kthehet në përputhje me traktatin dhe vuri në dukje se dëshimi i Rosisë për të shkëmbyer këto të dhëna do të jetë një shkelje e traktatit, duke i shtuar shkeljet ekzistuese të Traktatit të Ri START. "Në

interes të stabilitetit strategjik, SHBA-të do të vazhdojnë të promovojnë transparencën publike në nivelet dhe qëndrimin e forcës sonë bërthamore", - tha zëdhënësi i NSC.

Ukraina kërkoi takim urgjent të OKB-së

Ndërsa NATO e kritikoi Presidentin Putin, për retorikë "të rrezikshme dhe të papërgjegjshme" bërthamore, një ditë pasi ai tha se ka në plan të vendosë armë taktike bërthamore në Bjellorusi, Presidenti Putin e krahasoi manovrën e tij me vendosjen e armëve amerikane në Evropë. Ai këmbënguli se Rusia nuk do të shkelte premtimet e saj për mospërhapjen e armëve bërthamore. Edhe pse jo i papritur, plani është një nga sinjalet më të qarta bërthamore të Moskës që nga fillimi i agresionit të Kremlinit ndaj Ukrainës, 13 muaj më parë.

Ministria e Jashtme e Ukrainës bëri thirrje për një takim të jashtëzakonshëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pas njoftimit të Presidentit Putin dhe i kërkoi komunitetit ndërkombëtar që të "marrë masa vendimtare" për të parandaluar përdorimin e armëve bërthamore nga Rusia. "Rusia konfirmoi edhe një herë paafitësinë e saj kronike për të qenë një kujdestar i përgjegjshëm i armëve bërthamore, si një mjet frenimi dhe parandalimi i luftës, jo si një mjet kërcënimi dhe frikësimi", - thuhet në deklaratë.

Ndërsa Uashingtoni, superfuqia tjetër bërthamore në botë, hodhi poshtë shqetësimet rreth njoftimit të Presidentit Putin, NATO tha se premtimi i presidentit rus për mospërhapjen e armëve bërthamore dhe krahasimi me vendosjen e armëve amerikane jashtë vendit ishin shumë të gabuara. "Referenca ndaj armëve bërthamore të aleancës është tërësisht e gabuar. Vendet e NATO-s veprojnë në përputhje të plotë me angazhimet e tyre ndërkombëtare, - tha Aleanca, - është Rusia ajo që ka shkelur vazhdimisht angazhimet e saj për kontrollin e armëve".

Analistët e Institutit për Studimin e Luftës, me qendër në Uashington, thonë se rreziku i përshkallëzimit të luftës bërthamore mbetet jashtëzakonisht i ulët dhe plani i Rosisë është shqetësues dhe i hartuar për të frikësuar Perëndimin. "Putin po shfaq forcën ushtarake, në thelb një përpjekje për të ndjellë frikë. Armët bërthamore taktike përbëjnë shqetësim", - shprehet John Kirby, zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë për Sigurinë Kombëtare, ai tha gjithashtu se SHBA nuk kanë parë asnjë

sinjal se Presidenti rus Vladimir Putin po bënte përgatitje për përdorimin e armëve bërthamore. "Nuk kemi parë asnjë shenjë që mund të na sinjalizonte se Putini po përgatitet të përdorë në ndonjë mënyrë taktike armë bërthamore në Ukrainë. Po ashtu, mund t'u them se nuk kemi parë asgjë që do të na bënte të ndryshonim qëndrimin tonë strategjik bërthamor".

Këshilltari i Presidentit Volodymyr Zelenskiy për sigurinë, Oleksiy Danilov, tha se plani i Rosisë do të destabilizonte edhe Bjellorusinë, e cila, tha ai, ishte marrë "peng" nga Moskë. "Është hera e parë, që nga mesi i viteve 1990, që Rusia ndërmerr një hap të tillë". Një tjetër këshilltar i lartë i Presidentit Zelenskiy, tha se Putin pranon se ka frikë të humbasë dhe gjithçka që mund të bëjë është të ndjellë frikë përmes taktikave.

Shantazhi bërthamor i Putinit, çfarë do të thotë për Bjellorusinë

Me "shpalljen" e Putinit për vendosje të armëve bërthamore edhe në Bjellorusi, siç ndodh shpesh, stuhia e raportimeve alarmante pushtoi mediat, duke nxitur dhënien e detajeve. Është një taktikë që Rusia tashmë ka përdorur për armë bërthamore, duke tregtuar me kërcënime bosh për sulme të mundshme bërthamore për të penguar në mënyrë shumë efektive Perëndimin, që të mbështesë Ukrainën kundër luftës të Rosisë. Putini e ka thënë që nga fillimi i pushtimit në shkallë të gjerë, në shkurt 2022. Ai ka mobilizuar në një fushatë të gjatë të gjithë propaganduesit, ndikuesit, zëdhënësit dhe agentët e influencës të Rosisë në të gjithë Perëndimin, duke sjellë mesazhin e vetëm se Rusia nuk duhet të kundërshtohet sepse kjo do të shkaktojë luftë bërthamore. Rusia ka përdorur armët e saj bërthamore si një kartë për të shpëtuar nga pasojat e veprimeve të saj në Ukrainë.

Por kjo ka implikimet të menjëherëshme edhe për Bjellorusinë fqinje. Për vite me radhë, presidenti Aleksandër Lukashenko ia doli të ruante një shkallë pavarësie, dhe në veçanti të shmangte kontraktimin e mbrojtjes së Bjellorusisë ndaj aleatit të saj imagjinar Rosisë, për shembull, duke shmangur kërkesat e vazhdueshme ruse për një bazë ajrore atje.

Gjithçka ndryshoi pas zgjedhjeve të Bjellorusisë në gusht 2020. Duke u mbështetur më fort tek mbështetja ruse për të qëndruar në pushtet, Lukashenko hapi rrugën që kontrolli i Kremlinit të forcohej mbi vendin e tij. Ky ishte një parakusht thelbësor që Bjellorusia të lejonte që objektet e saj tokësore dhe hapësira ajrore të përdroreshin nga Rusia për sulmet ndaj Ukrainës në shkurt 2022. Forcat e armatosura të Bjellorusisë, me gjithë bashkëpunimin e tyre të ngushtë me ato të Rosisë, nuk kanë treguar prirje të dukshme për të shkuar në luftë për Moskën, pasi kjo do ta ekspozonte vendin e tyre ndaj reprezaljeve. Dhe raportimi i përhapur në fillim të këtij viti, se Rusia mund të përgatiste një sulm të ri ndaj Ukrainës nga territori bjellorus, tashmë është zhvlerësuar gjerësisht, pasi Rusia nuk ka vendosur forcat për ta bërë këtë. Por sulmet e dronëve ukrainas ndaj aseteve me vlerë të lartë brenda Bjellorusisë tregojnë se si Lukashenko, duke siguruar një zonë mbështetëse të pasme për operacionet ushtarake ruse, e ka bërë vendin e tij një objektiv. Pritja e armëve bërthamore ruse, nëse ndodh, do të thotë që Lukashenko po e ekspozon vendin e tij ndaj një rreziku edhe më të madh.

78 vjet histori skënderbegase, në kolanën e artë “Skënderbegasit ndër vite”

Me rastin e 78-vjetorit të krijimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, autorët Kujtim Boriçi e Maksim Fejzulla do të sillnin në duart e Skënderbegasve për këtë ditë të shënuar kolanën e pestë të librit “Skënderbegasit ndër vite....”.

Prania e kaq shumë pjesëmarrësve, krenaria dhe entuziazmi që vihet re në këtë promovim, shpreh qartë se ky libër është pritur me interes të madh, jo vetëm nga njerëzit në uniformën e gjelbër por dhe më gjerë. Kjo për dy arsye: së pari, se ky libër sjell jetën e gjallë, përkushtimin, sakrificën dhe arritjet e përfunduesve të më se 45 000 ish-skënderbegasve dhe, së dyti, se libri me ndërthurjen, koloritin dhe estetikën e paraqitjes, ka vlera të padiskutueshme.

